



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 220 prot

Durrës, më 11.02.2022

MIRATOI  
PREFEKTI  
Roland NASTO



**PROGRAMI VJETOR I PUNËS TË VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT TË PREFEKTIT TË QARKUT  
PËR VITIN 2022**

Bazuar në ligjin Nr.107/2016 “Për Prefektin e qarkut”, Urdhërin e Kryeministrit nr.50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të qarkut”, Rregulloren e Brendshme të institucionit miratuar me Urdhërin e Prefektit Nr.06, datë 22.01.2018 ”Për miratimin e Rregullores së Brendshme të institucionit të Prefektit të qarkut Durrës si dhe prioritetet dhe objektivat e institucionit, po ju paraqes programin vjetor të punës për vitin 2022 si më poshtë.

## PRIORITETET E INSTITUCIONIT TË PREFEKTIT TË QARKUT DURRËS PËR VITIN 2022

1. *Rimëkëmbja e Ekonomisë nga Tërmeti dhe Pandemia.*
2. *Mirqënia për të Gjithë.*
3. *Modernizimi për Zhvillim.*
4. *Familja.*
5. *Shqipëria e Fortë dhe e Sigurtë.*
6. *Mbrojtja Civile.*
7. **Zbatimi i Buxhetit të Institucionit të Prefektit, Shqyrtimi i Kërkesave dhe Ankesave të Qytetarit.**
8. **Respektimi i kuadrit ligjor për realizimin e programit qeveritar në arsim, shëndetësi, turizëm, punësim, bujqësi, uji i pijshëm, energji, siguria publike dhe shërbimi zjarrfikës.**
9. **Verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të organeve të njëjësive të vetëqeverisjes vendore dhe zbatimi i ligjshmërisë në veprimtarinë e institucionit të Prefektit.**
10. **Respektimi i kuadrit ligjor për realizimin e programit qeveritar në drejtim të Zhvillimit të Turizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit**
11. **Bashkërendimi i punës me Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve dhe strukturat e tjera vendore për finalizimin e një procesi zgjedhor brenda standarteve ndërkombëtare.**
12. **Lufta kundër korrupsionit, forcimit të integritetit të institucioneve dhe promovimi i vlerave, si dhe rritja e performancës në administratën publike në nivel Qarku.**

|  | Niveli              | Detyrat   | Fillimi | Mbarimi | Struktura Përgjegjëse | Struktura Bashkëpunuese |
|--|---------------------|---|---------|---------|-----------------------|-------------------------|
|  |                     | <b>RIMËKËMBJA E EKONOMISË NGA TËRMETI DHE PANDEMIA</b>                                  |         |         |                       |                         |
|  | <b>PRIORITETI I</b> |   |         |         |                       |                         |
|  | Objektiv A-1        | <b>Ngrihemi më të fortë pas dy goditjeve të njëpasnjëshme të tërmetit dhe pandemisë</b> |         |         |                       |                         |

| Output               |                   | Bashkëpunim me Ministritë përkatëse, Degët territoriale dhe Vetëqeverisjen Vendore   |             |             |  |   |
|----------------------|-------------------|--|-------------|-------------|--|---|
| 1                    | Aktivitet i A-1-1 | Ndjekja dhe monitorimi i të gjithë procedurave që po ndiqen nga Qeveria Shqiptare, Njësive të Vetëqeverisjes Vendore në nivel qarku në lidhje me menaxhimin e situatës post tërmetit në mënyrë të veçantë të procesit të rindërtimit | Gjatë vitit | Gjatë vitit | Të gjithë sektorët e institucionit të Prefektit.                           | Qeveria Shqiptare, Ministri i Shtetit për Rindërtim, Bashkitë e Qarkut, Prefektura                          |
| 2.                   | Aktivitet i A-1-2 | Menaxhimi i pandemisë ,mbajtja nën kontroll të përhapjes së virusit dhe shërimin brënda kushteve tejet të vështira   | Gjatë vitit | Gjatë vitit | Sektori i Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara | Ministria e Shëndetësisë ,sektori i Kujdesit Shëndetsor, Inspektoriati Shëndetsor,Spitali Rajonal,AKU, etj. |
| 3                    | Aktivitet i A-1-3 | Vaksinimi i popullatës   | Gjatë vitit | Gjatë vitit | Sektori i Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara | Ministria e Shëndetësisë ,sektori i Kujdesit Shëndetsor,Qëndrat Shëndetsore.                                |
| <b>PRIORITETI II</b> |                   | <b>MIRQËNIA PËR TË GJITHË</b>  |             |             |  |   |
| <b>Objektiv A-1</b>  |                   | <b>Taksa e ndershme progressive, rritja e pagave.</b>  |             |             |  |   |
| Output               |                   | Bashkëpunim me Ministritë përkatëse, Degët territoriale dhe Vetëqeverisjen Vendore   |             |             |  |   |
| 1                    | Aktivitet i A-1-1 | Sigurimi i zhvillimit të rritjes ekonomike për më shumë të ardhura, rritja e pagave dhe konsolidimi i përshpejtuar fiskal.   | Gjatë vitit | Gjatë vitit | Të gjithë sektorët e institucionit të Prefektit.                           | Degët territoriale dhe bashkitë   |
| 2.                   | Aktivitet i A1-2  | Ndjekja e rritjes së pagës për administratën e institucionit të prefektit  | Gjatë vitit | Gjatë vitit | Sekretari i Përgjithshëm.  | Ministria e Brëndëshme dhe Ministria e Fianancës  |
| <b>Objektivi A-2</b> |                   | <b>Respektimi i kuadrit ligjor për Bisnesin e vogël dhe familjen produktive</b>  |             |             |  |   |

| Output               |                   | Bashkëpunim me Degët territoriale dhe Vetëqeverisjen Vendore  |             |             |  |   |
|----------------------|-------------------|---|-------------|-------------|--|---|
| 1.                   | Aktivitet i A-2-1 | Ndjekja e mbështetjes së biznesit të vogël me zero taksa dhe familjet productive në qark.   | Gjatë vitit | Gjatë vitit | Sektori i Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara | Degët territoriale dhe bashkitë                                     |
| 2.                   | Aktivitet i A-2-2 | Ndjekja e nxitjes së investimeve me paisje të prodhuara brënda vëndit, me vëmëndje në paisjet që kursejnë energji dhe që janë miqësore ndaj mjedisit në qark. | Gjatë vitit | Gjatë vitit | Të gjithë sektorët e institucionit të Prefektit.                           | Degët territoriale dhe bashkitë                                     |
| <b>Objektivi A-3</b> |                   | <b>Respektimi i kuadrit ligjor për realizimin e zhvillimit të buqësisë dhe fshatit</b>  |             |             |  |   |
| Output               |                   | Rritja e bashkëpunimit me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe degët territoriale në drejtim të zhvillimit të Buqësisë dhe fshatit.                           |             |             |  |   |
| 1.                   | Aktivite ti A-3-1 | Ndjekja e zhvillimit të fshatit drejt turizmit rural  | Gjatë vitit | Gjatë vitit | Sektori i Zhvillimit Urban   | Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, bashkitë e qarkut Durrës.        |
| 2.                   | Aktivite ti A-3-2 | Ndjekja e rritjes së mbështetjes në buqësi, blegtori dhe zhvillim rural.  | 25Shkurt    | 25 Mars     | Sektori i Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara | Ministria e Buqësisë, Drejtoria e Buqësisë, Bashkitë dhe fermerët.. |
| 3.                   | Aktivite ti A-3-3 | Aplikimet për IPARD-3   | Qershor     | Shtator     | Sektori i Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara | MBZHR, Drejtoria e Buqësisë, Bashkitë dhe fermerët..                |
| 4.                   | Aktivite ti A-3-4 | Zbatimi i detyrave të përcaktuara nga strategjia e gjelbërt në bujqësi, kullota, pyje.  | Gjatë vitit | Gjatë vitit | Sektori i Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe                          | MBZHR, Dr Buqësisë, bashkitë dhe fermerët.                          |

|                       |                  |   |             |             |   |   |
|-----------------------|------------------|---|-------------|-------------|---|---|
|                       |                  | Mirëadministrimi i tokës bujqësore, të ujrave, kullimit etj.  |             |             | Funksioneve të Deleguara  |   |
| 5.                    | Aktiviteti A-3-5 | Grumbullimi i të dhënave statistikore të buqësisë, blegtorisë, agroturizmit etj.  | Gjatë vitit | Gjatë vitit | Spektori i Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara | MBZHR, Bashkitë, Dr Buqësisë dhe fermerët.  |
| 6.                    | Aktiviteti A-3-6 | Ndjekja për TVSH zero, të anijeve të peshkimit, për blerje të gazoilit me akcizë 0, dhe karburant si dhe karbon taksë zero.   | Gjatë vitit | Gjatë vitit | Spektori i Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara | MBZHR, Bashkitë, Dr Buqësisë dhe fermerët.  |
| <b>PRIORITETI III</b> |                  | <b>MODERNIZIM PËR ZHVILLIM</b>  |             |             |   |   |
| <b>Objektivi A-1</b>  |                  | <b>Respektimi i kuadrit ligjor për biznesin e manufakturës, teknologjisë së informacionit dhe shërbimeve.</b>   |             |             |   |   |
| <b>Output</b>         |                  | Rritja e bashkëpunimit me ministritë përkatëse, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe degët territoriale në drejtim të biznesit të manufakturës, teknologjisë së informacionit dhe shërbimeve. |             |             |   |   |
| 1..                   | Aktiviteti A-1-1 | Ndjekja nxitjes së punësimit, diversifikimin e produkteve shqiptare, rritja e eksporteve, përmisimi i kushteve të punës dhe trajtimit financiar për të punësuarit në këtë sektor.             | Gjatë vitit | Gjatë vitit | Spektori i Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara | Ministritë përkatëse, njësitë e vetëqeverisjes vendore, degët territoriale dhe sipërmarrësit privatë. |
| 2.                    | Aktiviteti A-1-2 | Ndjekja e mbështetjes të bizneseve në fushën e teknologjisë së informacionit në lehtësirat fiskale.   | Gjatë vitit | Gjatë vitit | Spektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse                              | Ministritë përkatëse, njësitë e vetëqeverisjes vendore.   |
| <b>Objektivi A-2</b>  |                  | <b>Implementimi i infrastrukturës rrugore, hekurudhore dhe detare.</b>  |             |             |   |   |
| <b>Output</b>         |                  | Rritja e bashkëpunimit me ministritë përkatëse, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe degët territoriale në drejtim të implementimit të infrastrukturës.                                       |             |             |   |   |
| 1.                    | Aktiviteti A-2-1 | Ndjekja e ndërtimit dhe rikonstruksionit të një rrjeti efikas dhe eficient të transportit rrugor të   | Gjatë vitit | Gjatë vitit | Spektori i Zhvillimit Urban   | ARRSH, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.  |

|    |                  |   |               |                    |                            |   |
|----|------------------|---|---------------|--------------------|----------------------------|---|
|    |                  | disponueshëm dhe të aksesueshëm nga të gjithë qytetarët në qarkun e Durrësit.   |               |                    |                            |   |
| 2. | Aktiviteti A-2-2 | Ndjekja e ridimensionimit dhe transformimit të infrastrukturës portuale dhe të transportit detar, përmes zgjerimit të zonave portualenë Durrës.   | Gjatë vitit   | Gjatë vitit        | Sektori i Zhvillimit Urban | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Durrës dhe APD.  |
| 3. | Aktiviteti A-2-3 | Ndjekja e implementimit të ngritjes dhe riparimit të rrjetit hekurudhor në qarkun e Durrësit.<br>Ndjekja dhe monitorimi i Projektit për ndërtimin e hekurudhës Tiranë-Rinas-Durrës, projekt ky që do të zbatohet kompania italiane INC spa. Projekti parashikon rehabilitimin e linjës hekurudhore Tiranë-Durrës, si dhe ndërtimin e një degëzimi hekurudhor prej 5 km ndërmjet Tiranës dhe Aeroportit të Rinasit | Janar 2022    | Janar 2023         | Sektori i Zhvillimit Urban | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, , Drejtoria e Përgjithshme e Hekurudhave Kompania italiane INC dhe Bashkitë Durrës, Tiranë dhe Vorë. |
| 4. | Aktiviteti A-2-4 | Ndjekja dhe monitorimi i ecurisë në vazhdimësi i procesit të transformimit të Portit të Durrësit në një hapësirë moderne të kompletuar me një marinë jahtesh, si një projekt për zhvillimin e infrastrukturës turiske dhe komplekse rezidenciale që do ta pozicionojë Shqipërinë në hartën e turizmit elitare mesdhetar.  | Gjatë vitit   | Gjatë vitit        | Sektori i Zhvillimit Urban | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Portual, Bashkia Durrës, Prefektura, etj  |
| 5. | Aktiviteti A-2-5 | Projektimi dhe ndërtimi I portit të ri të mallrave në Porto-Romano  | Gjatë vitit   | Gjatë vitit        | Sektori i Zhvillimit Urban | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Portual, Bashkia Durrës, Prefektura, etj  |
| 6. | Aktiviteti A-2-6 | Ndjekja e studimit për parkun Fotovoltaik të Spitalles.   | Gjatë vitit   | Gjatë vitit        | Sektori i Zhvillimit Urban | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Durrës.  |
| 7. | Aktiviteti A-2-7 | Ndjekja, monitorimi dhe koordinimi i punës për realizimin e procesit të   | Janar - Prill | Gjatë 6-mujorit të | Sektori i Zhvillimit Urban | ARRSH, Bashkitë e Qarkut Durrës, Prefektura   |

|                      |                  |  |             |                    |  |  |
|----------------------|------------------|--|-------------|--------------------|--|--|
|                      |                  | kalimit të pronësisë ndërmjet ARRSH dhe Njësisë të Vetqeverisjes Vendore të qarkut Durrës, kjo në zbatim të vendimit Nr. 600, datë 13.10.2021 "Për pronësinë e rrugëve shtetërore dhe kalimet e pronësisë ndërmjet enteve pronare të rrugëve"  |             | parë të vitit 2022 |  |  |
| 8.                   | Aktiviteti A-2-8 | Ndjekja dhe monitorimi i Sigurisë Rrugore me të gjithë elementet e saj në tërësi dhe menaxhimi i emergjencave të ndryshme  | Gjatë vitit | Gjatë vitit        | Sektori i Emergjencave Civile<br>Sektori i Zhvillimit Urban                                | ARRSH, Bashkitë e Qarkut Durrës, Prefektura, Policia Vendore e Policisë, etj               |
| 9.                   | Aktiviteti A-2-9 | Njohja, ndjekja dhe monitorimi i politikave qeveritare mbi politikat dhe kuadrin ligjor (ndryshimet në Kodin Rrugor) për rritjen e sigurisë rrugore si dhe për rritjen e investimeve në sistemet e monitorimit të trafikut dhe digjitalizimin e proceseve që kanë të bëjnë me përdoruesit e automjeteve dhe sjelljen e tyre. | Gjatë vitit | Gjatë vitit        | Sektori i Koopetencave Vendnore dhe Funksioneve të Deleguara<br>Sektori i Zhvillimit Urban | ARRSH, Bashkitë e Qarkut Durrës, Prefektura, Policia Vendore e Policisë, etj               |
| <b>Objektivi A-3</b> |                  | <b>Respektimi i kuadrit ligjor për realizimin e programit qeveritar për Ujin e Pijshëm, energjinë elektrike.</b>   |             |                    |  |  |
| <b>Output</b>        |                  | <b>Rritja e bashkëpunimit me ministrinë përkatëse, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe degët territoriale në drejtim të implementimit të reformës së energjisë dhe ujit të pijshëm.</b>   |             |                    |  |  |
| 1.                   | Aktiviteti A-3-1 | Ndjekja e realizimit të furnizimit normal të komunitetit me ujë të pijshëm, energji dhe marrja në mënyrë të vazhdueshme e informacioneve mbi gjendjen e ujit të pijshëm, të energjisë në qarkun e Durrësit. Ndjekja e ecurisë së nivelit të arkëtimeve në këto dy shërbime si  | Gjatë vitit | Gjatë vitit        | Sektori i Zhvillimit Urban   | Bashkitë e Qarkut, OSHEE, Ujësjetllës Kanalizime sh.a Durrës dhe Krujë, Degët territoriale |

|                      |                  |  |             |             |  |  |
|----------------------|------------------|--|-------------|-------------|--|--|
|                      |                  | dhe e problematikave të ndryshme që muan të dalin sipas specifikave  |             |             |  |  |
| 2.                   | Aktiviteti A-3-2 | Ndjekja dhe monitorimi i ecurisë së punës në drejtim të investimeve të ndryshme në drejtim të rrjetit të ujit të pijshëm dhe kanalizimeve në nivel qarku, ndërhyrjeve nga grupet e punës për shkëputjen e lidhjeve të paligjësme nga rrjeti i furnizimit me ujë të pishëm, përmisimi i nivelit të arkëtimit dhe paisja me matësa të çdo përdoruesi.  | Gjatë vitit | Gjatë vitit | Sektori i Zhvillimi Urban                                | Bashkitë e Qarkut, Ujësjetës Kanalizime sh.a Durrës dhe Krujë  |
| 3                    | Aktiviteti A-3-3 | Përmisimi i nivelit të arkëtimit dhe ulje të nivelit të humbjeve në rrjet (Energji elektrike/ujë i pijshëm).   | Gjatë vitit | Gjatë vitit | Sektori i Zhvillimi Urban                                | Bashkitë e Qarkut, OSHEE, UKD, UKK, Degët Territoriale   |
| <b>Objektivi A-4</b> |                  | <b>Ndjekja e procesit të transferimit të së drejtës së pronësisë shtetërore të personit juridik ose fizik, privat.</b>   |             |             |  |  |
| <b>Output</b>        |                  | <b>Rritja e bashkëpunimit me institucionet shtetërore dhe private.</b>   |             |             |  |  |
| 1.                   | Aktiviteti A-4-1 | Konfirmimi i planvendosjeve të objekteve shtetërore që privatizohen, të regjistruara në protokollin e institucionit. (në zbatim të VKM-së Nr. 413, datë 25.06.2014 "Për përcaktimin e kriterëve e të procedurave të shitjes së trojeve në përdorim, sipërfaqe të domosdoshme, dhe trojeve shtesë funksionale të ndërmarrjeve shoqërive tregtare, të objekteve shtetërore të veçuara, të privatizuara, të objekteve apo ndërtesave të shitura | Gjatë vitit | Gjatë vitit | Sektori i Zhvillimit Urban<br>(specialisti i autorizuar) | Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë<br>(Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike)<br>Dega e Shoqërive Publike |



|                    |                  |  |             |             |  |   |
|--------------------|------------------|--|-------------|-------------|--|---|
|                    |                  | të ish-kooperativave bujqësore, si dhe të ndërtesave të ndërtuara në bazë të lejeve të ndërtimit”, ndryshuar me VKM nr. 603, datë 31.08.2016; nr.38, datë 24.01.2018)  |             |             |  |   |
| 2.                 | Aktiviteti A-4-2 | Ndjekja e procedurave dhe afateve të parashikuara në aktet ligjore për verifikimin e akteve të institucioneve mbështetëse të mësipërme   | Gjatë vitit | Gjatë vitit | Sektori i Zhvillimit Urban<br>(specialisti i autorizuar) | -   |
| 3.                 | Aktiviteti A-4-3 | Përgatitja e shkresave përcjellëse mbi bazueshmërinë ligjore të akteve të institucioneve mbështetëse të mësipërm.  | Gjatë vitit | Gjatë vitit | Sektori i Zhvillimit Urban<br>(specialisti i autorizuar) | -   |
| <b>Objekti A-5</b> |                  | <b>Zbatimi i legjislacionit në drejtim të zhvillimit të turizmit dhe mbrojtjes së mjedisit.</b>  |             |             |  |   |
| <b>Output</b>      |                  | <b>Rritja e bashkëpunimit me institucionet shtetërore dhe private.</b>   |             |             |  |   |
| 1.                 | Aktiviteti A-5-1 | Ndjekja dhe monitorimi i ecurisë sezonale e vjetore të Turizmit në qark gjatë vitit 2022 si dhe grumbullimi i të dhënave statistikore të lëvizjes së turistëve vendas dhe të huaj 3-mujore, 6-mujore, 9-mujore dhe vjetore për vitin 2021. | Gjatë vitit | Gjatë vitit | Sektori i Zhvillimit Urban                               | MTM , Prefektura, Bashkitë e Qarkut, Degët Territoriale |
| 2.                 | Aktiviteti A-5-2 | Ngritja dhe funksionimi i Task-Forcës Vendore për sigurinë në zonat bregdetare/plazhet.  | Maj         | Tetor       | Sektori i Zhvillimit Urban dhe Task-Forca Vendore.       | Prefektura, Bashkitë e Qarkut, Degët Territoriale       |
| 3.                 | Aktiviteti A-5-3 | Ecuria dhe monitorimi i sezonit veror turistik në qarkun e Durrësit, sigurimi i të dhënave statistikore .  | Maj         | Nëntor      | Sektori i Zhvillimit Urban dhe Task-Forca Vendore.       | Prefektura, Bashkitë e Qarkut, Degët Territoriale       |

|    |                  |  |   |                                     |  |  |
|----|------------------|--|---|-------------------------------------|--|--|
| 4. | Aktiviteti A-5-4 | Ndjekja dhe monitorimi i ecurisë së sezonit turistik dimror/ veror për hyrjet dhe daljet nga PKK të trageteve në portin e Durrësit.  | Gjatë vitit<br>Janar 2022                 | Dhjetor<br>2022                     | Sektori i Zhvillimit Urban dhe Task-Forca Vendore. | Prefektura dhe të gjithë institucionet pjesmarrëse në port.  |
| 5. | Aktiviteti A-5-5 | Ndjekja dhe bashkëpunimi i politikave që ndiqen në drejtim të Turizmit me Shkollat profesionale dhe Universitetin "Aleksandër Moisiu"  | Gjatë vitit<br>Dhjetor2022<br>Qershor2022 | Gjatë vitit<br>Janar 22<br>Tetor 22 | Sektori i Zhvillimit Urban dhe Task-Forca Vendore. | Prefektura dhe të gjithë institucionet arsimore përgjegjëse  |
| 6. | Aktiviteti A-5-6 | Njohja dhe implementimi i politikave dhe kuadrit ligjor të qeverisë shqiptare në drejtim të riorganizimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit me ligj të ri të dedikuar si dhe menaxhimin e Integruar të Bregdetit, si dhe forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional me bashkitë bregdetare në mënyrë specifike me Bashkinë Durrës.  | Gjatë vitit                               | Gjatë vitit                         | Sektori i Zhvillimit Urban                         | Këshilli i Ministrave, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Inspektoriatet, Prefektura, Bashkia Durrës |
| 7. | Aktiviteti A-5-7 | Njohja dhe implementimi i politikave të qeverisë shqiptare dhe institucioneve përgjegjëse në drejtim të zhvillimit turistik, nëpërmjet inkurajimit të brandeve të mirënjohura ndërkombëtare për të investuar apo operuar në Shqipëri, promovimi i Flamurit Shqiptar në tregun ndërkombëtar, si destinacion tax-free; përgjigjeve të flukesave të pritshme turistike dhe të kërkesave në rritje të operatorëve turistikë në qarkun tonë | Gjatë vitit                               | Gjatë vitit                         | Sektori i Zhvillimit Urban                         | Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Prefektura, Njësitë e Vetqeverisjes Vendore qarku Durrës          |
| 8. | Aktiviteti A-5-8 | Ndjekja dhe monitorimi i politikave implementuese nga qeveria shqiptare, njësitë e vetqeverisjes   | Gjatë vitit                               | Gjatë vitit                         | Sektori i Zhvillimit Urban                         |  |

|                      |                  |   |             |             |  |   |
|----------------------|------------------|---|-------------|-------------|--|---|
|                      |                  | vendore dhe operatorët turistik të qarkut Durrës në drejtim të zhvillimit agroturizmit në qarkun Durrës   |             |             |  | Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Prefektura, Njësitë e Vetqeverisjes Vendore qarku Durrës<br>D.R.E.Bujqësor |
| <b>Objektivi A-6</b> |                  | <b>Zbatimi i legjislacionit në drejtim të zhvillimit dhe të mbrojtjes së mjedisit.</b>  |             |             |  |   |
| <b>Output</b>        |                  | <b>Rritja e bashkëpunimit me institucionet shtetërore dhe private.</b>  |             |             |  |   |
|                      |                  |   |             |             |  |   |
| 1.                   | Aktiviteti A-6-1 | Mbrojtja e mjedisit, në menaxhimin e integruar të mbetjeve në tërësinë e territorit sipas masterplanit.   | Gjatë vitit | Gjatë vitit | Sektori i Zhvillimit Urban             | MTM , bashkitë dhe ISHMPUT.   |
| 2.                   | Aktiviteti A-6-2 | Reduktimi me synim zhdukjen e ambalazhit plastik njëpërdorimësh.  | Gjatë vitit | Gjatë vitit | Sektori i Zhvillimit Urban             | MTM , bashkitë, prefektura, degët territoriale, biznesi dhe qytetarët.  |
| 3.                   | Aktiviteti A-6-3 | Ndjekja e buxhetit të bashkive Durrës, Shijak dhe Krujë në menaxhimin e mbetjeve  | Gjatë vitit | Gjatë vitit | Sektori i Zhvillimit Urban             | MTM , bashkitë, prefektura,   |
| 4.                   | Aktiviteti A-6-4 | Ndjekja dhe monitorimi i zbatimit të detyrimeve ligjore në drejtim të mbrojtjes së mjedisit.  | Gjatë vitit | Gjatë vitit | Sektori i Zhvillimit Urban             | Prefektura, Bashkitë e Qarkut, Degët territoriale   |
| 5.                   | Aktiviteti A-6-5 | Mbikqyrja dhe monitorimi i zonave të mbrojtura në qark (Rrushkull, Qafë Shtamë, Krastë-Verjon)  | Gjatë vitit | Gjatë vitit | Sektori i Zhvillimit Urban dhe Juridik | MTM, Komiteti i Zonave të Mbrojtura.  |
| 6.                   | Aktiviteti A-6-6 | Ndjekja dhe monitorimi i Planeve të Veprimit për pastrimin e territorit nga tre Njësitë e Vetqeverisjes Vendore qarku Durrës, në kuadër të detyrave të lëna nga Kryeministri për çlirimin e territorit nga ndotja mjedisore | Gjatë vitit | Gjatë vitit | Sektori i Zhvillimit Urban             | MTM, Bashkitë e Qarkut Durrës, Prefektura, degët Territoriale, shoqëria civile, organizata të ndryshme OJF.   |

|                      |                  |   |             |             |                            |  |
|----------------------|------------------|---|-------------|-------------|----------------------------|--|
| 7.                   | Aktiviteti A-6-7 | Ndjekja, kontrolli dhe monitorimi në vijimësi i punës për zbatimin e kompetencave të pushtetit vendor në fushën e Mjedisit.   | Gjatë vitit | Gjatë vitit | Sektori i Zhvillimit Urban | Bashkitë e Qarkut, Prefektura                            |
| 8.                   | Aktiviteti A-6-8 | Takime dhe ndjekje të zbatimit të planit për hedhjen e pelerave në Vend-depozitimin e Tiranës   | Janar       | Gjatë vitit | Sektori i Zhvillimit Urban | Ministria e Turizmit dhe Mjedisit<br>Bashkia Durrës, etj |
| 9.                   | Aktiviteti A-6-9 | Takime dhe ndjekje të zbatimit të planit për hedhjen e pelerave në Vend-depozitimin e Tiranës   | Janar       | Gjatë vitit | Sektori i Zhvillimit Urban | Ministria e Turizmit dhe Mjedisit<br>Bashkia Durrës, etj |
| <b>Objektivi A-7</b> |                  | <b>Zbatimi i legjislacionit në drejtim të zhvillimit urban</b>  |             |             |                            |  |
| <b>Output</b>        |                  | <b>Rritja e bashkëpunimit me njësitë e vetëqeverisjes vendore në drejtim të zhvillimit urban</b>  |             |             |                            |  |
| 1.                   | Aktiviteti A-7-1 | Nxiti dhe mbështetja e zhvillimit të zonave rurale nëpërmjet programeve dhe projekteve infrastrukturore dhe urbane.   | Gjatë vitit | Gjatë vitit | Sektori i Zhvillimit Urban | Bashkitë e Qarkut, Prefektura                            |
| 2.                   | Aktiviteti A-7-2 | Dhënie konsulence teknike për nismën për hartimin apo rishikimin e Planit të Përgjithshëm Vendor.   | Gjatë vitit | Gjatë vitit | Sektori i Zhvillimit Urban | Bashkitë e Qarkut, Prefektura                            |
| 3.                   | Aktiviteti A-7-3 | Ndjekja e takimeve të ndryshme si <i>Seanca për Dëgjesa Publike</i> etj. të organizuara nga bashkitë e qarkut në kuadër të hartimit të instrumentit vendor të planifikimit. | Gjatë vitit | Gjatë vitit | Sektori i Zhvillimit Urban | Bashkitë e Qarkut, Prefektura                            |
| 4.                   | Aktiviteti A-7-4 | Ndjekja dhe monitorimi i punës në lidhje me zbatimin e projektit "Eko Park" në zonën e Porto Romanes.   | Janar       | Qershor     | Sektori i Zhvillimit Urban | Ministria e Turizmit dhe Mjedisit<br>Bashkia Durrës, etj |
| <b>Objektivi A-8</b> |                  | <b>Zbatimi i legjislacionit në drejtim të zhvillimit kulturës</b>   |             |             |                            |  |

| Output                 |                  | <b>Rritja e bashkëpunimit me njësitë e vetëqeverisjes vendore në drejtim të zhvillimit të kulturës</b>   |             |             |                                     |  |
|------------------------|------------------|--|-------------|-------------|-------------------------------------|--|
| 1.                     | Aktiviteti A-8-1 | Ndjekja dhe monitorimi i ecurisë së projektit të Rijetëzimit të Amfiteatrit Durrës, rehabilitimit të qendrës historike, rivitalizimi i disa monumenteve historike me ndihmën e projektit EU4Culture, kjo për ti dhënë edhe më tepër një vlerë të shtuar kulturës dhe historisë së antikitetit por edhe turizmit në bashkinë Durrës | Gjatë vitit | Gjatë vitit | Sektori i Zhvillimit Urban          | Ministria e Kulturës, Bashkia Durrës, Prefektura   |
| 2.                     | Aktiviteti A-8-2 | Ndjekja dhe bashkëpunimi për të gjitha festat lokale, kombëtare dhe aktivitetet e ndryshme të zhvilluara nga bashkitë, institucionet lokale, shkollat dhe shoqatat   | Gjatë vitit | Gjatë vitit | Sekretari i Përgjithshëm, Sektorët. | Ministria e Kulturës, bashkitë e qarkut, institucionet lokale, shkollat, shoqatat Prefektura |
| <b>Objektivi A-9</b>   |                  | <b>Zbatimi i legjislacionit në drejtim të shoqërisë digjitale</b>  |             |             |                                     |  |
| Output                 |                  | Një Shqipëri e digjitalizuar në fuksion të qytetarit, sipërmarrjes dhe gjeneratës së re.   |             |             |                                     |  |
| 1.                     | Aktiviteti A-9-1 | Ndjekja e përmisimit dhe modernizimit të sistemeve elektronike të gjithë sektorët me synim automatizmin dhe lehtësimin e jetës së qytetarit dhe biznesit si dhe aktivitetit të administratës publike.  | Gjatë vitit | Gjatë vitit | Sekretari i Përgjithshëm, Sektorët. | Ministritë, bashkitë dhe institucionet.  |
| <b>PRIORITETI I IV</b> |                  | <b>FAMILJA</b>   |             |             |                                     |  |

|                      |                  |  |             |             |  |   |
|----------------------|------------------|--|-------------|-------------|--|---|
| <b>Objektivi A-1</b> |                  | <b>Zbatimi i legjislacionit për një familje të fortë.</b>  |             |             |  |   |
| <b>Output</b>        |                  | <b>Rritja e bashkëpunimit me njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet në drejtim të mbështetjes së familjes së fortë.</b>   |             |             |  |   |
| 1.                   | Aktiviteti A-1-1 | Ndjekja e mbështetjes së familjeve në hapat e para fillestare të krijimit të saj.  | Gjatë vitit | Gjatë vitit | Sekretari i Përgjithshëm, Sektorët.                  | Ministritë, bashkitë dhe institucionet. |
| 2.                   | Aktiviteti A-1-2 | Ndjekja për familjet e reja të programit të strehimit, bonusit për bebet. Investimet e ndryshme në ndërtimin dhe ngritjen e infrastrukturës për kujdesin e edukimin e fëmijve në kushte bashkohore.    | Gjatë vitit | Gjatë vitit | Sekretari i Përgjithshëm, Sektorët.                  | Ministritë, bashkitë dhe institucionet. |
| 3.                   | Aktiviteti A-1-3 | Ndjekja e nxitjes së strehimit, punësimit rinor, të grave dhe vajzave, rritja e ndihmës , ekonomike, pensioneve, duke rritur njëkohësisht në sasi e cilësi të gjitha shërbimet e shtetit për familjen. | Gjatë vitit | Gjatë vitit | Sekretari i Përgjithshëm, Sektorët.                  | Ministritë, bashkitë dhe institucionet. |
| <b>Objektivi A-2</b> |                  | <b>Zbatimi i legjislacionit në drejtim të strehimit</b>  |             |             |  |   |
| <b>Output</b>        |                  | <b>Rritja e bashkëpunimit me njësitë e vetëqeverisjes vendore për strehimin</b>  |             |             |  |   |
| 1.                   | Aktiviteti A-2-1 | Ndjekja e aplikimeve për strehim, duke rritur transparencën si dhe programin e banesave sociale  | Gjatë vitit | Gjatë vitit | Sekretari i Përgjithshëm, Sektori i Zhvillimit Urban | Bashkitë e qarkut Durrës                |

|                      |                  |  |             |             |   |   |
|----------------------|------------------|--|-------------|-------------|---|---|
|                      |                  |  |             |             |   |   |
| 2.                   | Aktiviteti A-2-2 | Si përfitues prioritarë të programit social për strehim do të ndjekim rritjen e numrit të të grave kryefamiljare, personave me aftësi të kufizuara, jetimëve, komunitetit rom dhe egjiptian.                       | Gjatë vitit | Gjatë vitit | Sekretari i Përgjithshëm, Sektori i Zhvillimit Urban  | Bashkitë e qarkut Durrës                |
| <b>Objektivi A-3</b> |                  | <b>Zbatimi i legjislacionit për fëmijët.</b>   |             |             |   |   |
| <b>Output</b>        |                  | <b>Bashkëpunimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore për forcimin e rritjes së kujdesit, rritjes dhe edukimit për fëmijët.</b>  |             |             |   |   |
| 1.                   | Aktiviteti A-3-1 | Ndjekja e zbatimit të paketës së plotë për kujdesin e rritjes së fëmijëve.   | Gjatë vitit | Gjatë vitit | Sekretari i Përgjithshëm, Sektorët.<br>Sektori i Koopetencave Vendnore dhe Funksioneve të Deleguara | Ministritë, bashkitë dhe institucionet. |
| 2.                   | Aktiviteti A-3-2 | Ndjekja e vijimit me transformimin e çerdheve, kopshteve e shkollave me hapsira denjtoze për kujdesin, rritjen dhe edukimin e fëmijëve duke e zgjeruar funksionin e tyre e duke I kthyer në qendra komunitare që u | Gjatë vitit | Gjatë vitit | Sekretari i Përgjithshëm, Sektorët.<br>Sektori i Koopetencave Vendnore dhe                          | Ministritë, bashkitë dhe institucionet. |

|               |                   |  |             |  |   |   |
|---------------|-------------------|--|-------------|--|---|---|
|               |                   | shërbejnë familjeve e banorëve përreth.  |             |  | Funksioneve të Deleguara  |   |
| 3             | Aktiviteti A-3-3  | Ndjekja në vijimsi e dy programeve të dedikuara falas për kujdesin e syve dhe atë oral për të gjithë fëmijët e moshës6-15 vjeç.  | Gjatë vitit | Gjatë vitit                            | Spektori i Koopetencave Vendnore dhe Funksioneve të Deleguara               | Ministritë,bashkitë dhe institucionet.-   |
| Objektivi A-4 |                   | <b>Respektimi i kuadrit ligjor për realizimin e programit qeveritar për Arsimin.</b>   |             |  |   |   |
| Output        |                   | Të realizohen objektivat e Qeverisë në reformën e Arsimit universitar dhe Parauniversitar për vitin 2019.  |             |  |   |   |
| 1.            | Aktiviteti A-4-1  | Ndjekja dhe monitorimi i procesit të arsimit parashkollor , parauniversitar dhe universitar 2021 – 2022 në rang qarku.<br>Ndjekja e fillimit të vitit arsimor parauniversitar 2021-2022. | Gjatë vitit | Gjatë vitit<br>Muaji shtator - vazhdim | Spektori i Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara | Dr.Rajonale e Arsimit Parauniversitar,ZVA, Durrës,Krujë,Shijak, rektoriati i UAM dhe Bashkitë.      |
| 2.            | Aktiviteti A-4 -2 | Ndjekja e të mësuarit të gjuhës Angleze që nga klasa e parë e arsimit bazë, hapja e klasave të profilizuara sportive, në vitin mësimor 2021-2022.  | Gjatë vitit | Gjatë vitit<br>Muaji shtator - vazhdim | Spektori i Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara | Dr.Rajonale e Arsimit Parauniversitar,ZVA, Durrës,Krujë,Shijak, drejtorët e shkollave dhe Bashkitë. |
| 3.            | Aktiviteti A-4-3  | Ndjekja e shpërndarjes së tekseve falas nga klasa e parë deri në klasën e nëntë të arsimit parauniversitar.  | Gjatë vitit | Gjatë vitit<br>Muaji shtator - vazhdim | Spektori i Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara | Dr.Rajonale e Arsimit Parauniversitar,ZVA, Durrës,Krujë,Shijak, drejtorët e shkollave dhe Bashkitë. |



|                      |                  |   |             |               |  |   |
|----------------------|------------------|---|-------------|---------------|--|---|
| 4.                   | Aktiviteti A-4-4 | Vazhdimi i rindërtimit, rinovimit të shkollave të dëmtuara nga tërmeti i 26 Nëntorit të vitit 2019 në qarkun e Durrësit.                                  | Gjatë vitit | Gjatë vitit   | Sektori i Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara | Dr.Rajonale e Arsimit Parauniversitar,ZVA, Durrës,Krujë,Shijak, drejtorët e shkollave dhe Bashkitë.                                   |
| 5.                   | Aktiviteti A-4-5 | Krijimi i infrastrukturës së nevojshme dhe bazës materiale shkollore për ecurinë normale të procesit mësimor; të çerdheve, kopshteve, shkollave dhe UAMD. | Gjatë vitit | Gjatë vitit   | Sektori i Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara | Dr.Rajonale e Arsimit Parauniversitar,ZVA, Durrës,Krujë,Shijak, drejtorët e shkollave, , rektoriati i UAM dhe Bashkitë.               |
| 6.                   | Aktiviteti A-4-6 | Ndjekja e hapjes dhe vijimi i programeve në gjuhën angleze në UAMD  | Gjatë vitit | Gjatë vitit   | Sektori i Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara | MASR dhe UAM Durrës.  |
| 7.                   | Aktiviteti A-4-7 | Regjistrimi i fëmijve në shkollë në veçanti në klasën e parë.   | Gjatë vitit | Shtator-Tetor | Sektori i Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara | Dr.Rajonale e Arsimit Parauniversitar,ZVA, Durrës,Krujë,Shijak, drejtorët e shkollave , Bashkitë dhe Dr.Vendore e policisë së Qarkut. |
| <b>Objektivi A-5</b> |                  | <b>Zbatimi I legjislacionit për rritjen e kujdesit për të moshuarit dhe qytetarëve në nevojë</b>  |             |               |  |   |
| <b>Output</b>        |                  | <b>Rritja e bashkëpunimit me bashkitë dhe institucionet për të moshuarit dhe qytetarëve në nevojë</b>   |             |               |  |   |
| 1.                   | Aktiviteti A-5-1 | Mbështetja me vëmendje të veçantë përmes zgjerimit e rritjes financiare të programeve për mbrojtje dhe  | Gjatë vitit | Gjatë vitit   | Sektori i Monitorimit të Kompetencave                                      | MARS, institucionet dhe bashkitë.   |

|                      |                  |  |             |             |   |   |
|----------------------|------------------|--|-------------|-------------|---|---|
|                      |                  | përfshirje sociale, duke ju përgjigjur nevojave të personave në moshën e tretë dhe komuniteteve ne nevojë.   |             |             | Vendore dhe Funksioneve të Deleguara  |   |
| 2.                   | Aktiviteti A-5-2 | Ndjekja nëpërmjet Fondit Social të zgjerimit të rrjetit të qendrave dhe shërbimeve të rejanë territorin e qarkut Durrës, për fëmijët, gratë dhe të moshuarit në nevojë të gjitha bashkitë e qarkut Durrës. | Gjatë vitit | Gjatë vitit | Spektori i Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara | MARS, Fondi Social dhe bashkitë.        |
| 3.                   | Aktiviteti A-5-3 | Ndjekja e zgjerimit të mbulimit të familjeve të varfëra me skemën e ndihmës ekonomike, me parparësi familjet e komunitetit rom dhe atij egjiptian, me 10% në vit si dhe të grave kryefamiljare.            | Gjatë vitit | Gjatë vitit | Spektori i Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara | MARS, institucionet dhe bashkitë.       |
| <b>Objektivi A-6</b> |                  | <b>Respektimi i kuadrit ligjor për realizimin e programit qeveritar për Shëndetësinë Shqipëria e Shëndetshme</b>   |             |             |   |   |
